

VENDIM
Nr.58, datë 1.2.2006

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E KONTROLLIT TË PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES, PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS SË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT PËR ÇIMENTOT, PËR TË CILAT KA RËNDËSI PARËSORE REZISTENCA DHE QËNDRUESHMËRIA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 25 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për procedurat e kontrollit të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, për marrjen e certifikatës së vlerësimit të konformitetit, për çimentot, për të cilat ka rëndësi parësore rezistenca dhe qëndrueshmëria”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE

MBI PROCEDURAT E KONTROLLIT TË PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES, PËR MARRJEN E CERTIFIKATËS SË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT, PËR ÇIMENTOT PËR TË CILAT KA RËNDËSI PARËSORE REZISTENCA DHE QËNDRUESHMËRIA

PJESA I

PROCEDURA PËR KONTROLLIN E PRODUKTIT NË FABRIKË DHE NË QENDRËN E SHPËRNDARJES SË ÇIMENTOVE

1. Qëllimi dhe fusha e aplikimit

Procedura ka si qëllim që të përcaktojë kërkesat për një sistem kontrolli të produktit në fabrikë dhe në qendrën e shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet çimento sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, që mund të përdoret për prodhimin e një betoni normal, të armuar ose të paranderur dhe për të cilat ka rëndësi rezistenca dhe qëndrueshmëria.

Procedura aplikohet në fabrikë nga prodhuesi i çimentos ose në qendrën e shpërndarjes nga ndërmjetësi, ose mund të jetë specifike.

2. Kërkesat e fabrikës. Detyrat e prodhuesit

Quhet fabrikë, linja që përdoret për prodhimin dhe shitjen e çimentos, e cila është e përshtatshme për një prodhim të vazhdueshëm në masë të saj, disponon impiante të mjaftueshme për bluarje dhe homogjenizim, si dhe kapacitetet e nevojshme për depozitim, personel ekspert dhe pajisje të përshtatshme për të provuar, vlerësuar dhe korrigjuar cilësinë e produktit.

Prodhuesi demonstroi se ka një sistem kontrolli të procesit në fabrikë ose një sistem cilësie, për të siguruar që çimentoja e prodhuar është konform kërkesave të standardit S SH EN 197-2.

Prodhuesi duhet të dokumentojë aktivitetin e kontrollit të cilësisë nëpërmjet manualit të cilësisë, për çdo fabrikë.

Prodhuesi bën një deklaratë që përcakton politikën, objektivat për cilësinë dhe mjetet e vëna në dispozicion për arritjen e cilësisë së produktit dhe e bën të njohur këtë politikë në të gjitha nivelet e fabrikës.

Prodhuesi përshkruan në manualin e cilësisë strukturën organizative, përgjegjësitë dhe detyrat për arritjen e cilësisë së produktit, përshkruan format e aplikuar për realizimin e cilësisë së parashikuar, si dhe funksionimin efektiv të kontrollit në prodhimin e çimentos.

Prodhuesi duhet të caktojë një përfaqësues, i cili pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, ka përgjegjësi dhe autoritet të veçantë për të siguruar se detyrat e kontrollit të prodhimit në fabrikë janë aplikuar e ndjekur.

Prodhuesi të paktën një herë në vit, rishikon sistemin e kontrollit të cilësisë së prodhimit, edhe nëpërmjet inspektimeve, për t'u siguruar për aftësinë dhe efikasitetin e tij.

Manuali i cilësisë përcakton procedurat që duhen zbatuar, në mënyrë që çimentoja e prodhuar dhe e nxjerrë në treg të jetë në konformitet me standardet dhe rregullat teknike në fuqi.

Çdo lloj ndryshimi thelbësor në manualin e cilësisë ose në procesin e shpërndarjes së produkteve që tregtohen rifuxho, i bëhet e ditur organizmit që ushtron të drejtën e kontrollit, brenda dy muajve nga vënia në zbatim, prej përfaqësuesit të drejtorisë.

3. Kërkesat për qendrën e shpërndarjes. Detyrat e ndërmjetësit

Quhet qendër shpërndarje, impianti i lëvizjes së çimentos, që nuk ndodhet brenda fabrikës, i cili e merr çimenton rifuxho dhe e depoziton, paketon dhe shpërndan, rifuxho ose në thasë.

Qendra e shpërndarjes trajton vetëm produkte me dëshmi konformiteti.

Ndërmjetësi që menaxhon një qendër shpërndarje, është një person fizik ose juridik, i cili merr prej prodhuesit sasinë e çimentos të certifikuar sipas S SH EN-19-2, ka të drejtën e përdorimit të markës së konformitetit të vendosur nga prodhuesi, nëse provon që vetitë e çimentos rifuxho të furnizuar janë ruajtur gjatë fazës së transportit, marrjes, depozitimit, ambalazhimit dhe shpërndarjes. Konformiteti vlerësohet në bazë të standardeve.

Ndërmjetësi dokumenton aktivitetin e përshkruar më sipër nëpërmjet manualit të cilësisë, për çdo qendër shpërndarje.

Ndërmjetësi harton një deklaratë ku përcakton politikën, objektivat për cilësinë dhe masat e marra për ruajtjen e cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë dhe siguron se kjo politikë është bërë e njohur në të gjitha nivelet.

Ndërmjetësi shpjegon në manualin e cilësisë strukturën organizative, përgjegjësitë dhe mundësitë e drejtimit në lidhje me ruajtjen e cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë. Gjithashtu përshkruan mjetet e përdorura për të kontrolluar cilësinë e çimentos, si dhe efektivitetin e funksionimit të sistemit të cilësisë.

Ndërmjetësi cakton një përgjegjës për cilësinë, i cili pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera, ka autoritet dhe përgjegjësi të veçantë, për të siguruar se rregullat e kontrollit gjatë furnizimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së çimentos, janë aplikuar dhe zbatuar konform standardeve të rregullores.

Ndërmjetësi të paktën një herë në vit rishikon sistemin e kontrollit të cilësisë së furnizimit, ruajtjes dhe shpërndarjes së çimentos, nëpërmjet verifikimeve inspektuese, për t'u siguruar mbi aftësinë dhe efikasitetin e sistemit të kontrollit, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e parashikuara në rregullore.

Manuali i cilësisë së ndërmjetësit përshkruan procedurat e zbatuara dhe të përdorura për sistemin e kontrollit të cilësisë së çimentos së furnizuar dhe shpërndarë, si dhe referon në të dokumentet që përmbajnë të dhënat e fundit rreth provave të autokontrollit dhe të kontrollit të cilësisë.

Çdo lloj ndryshimi thelbësor në manualin e cilësisë i duhet bërë e ditur nga përfaqësuesi i drejtorisë, organizmit të autorizuar, brenda një muaji nga vënia në zbatim.

4. Kontrolli në fabrikë. Detyrimet e prodhuesit

Drejtuari i fabrikës është përgjegjës për kontrollin e dokumentacionit dhe të dhënave që lidhen me kontrollin e prodhimit në fabrikë, si dhe zbatimin e rregullores.

Dokumentet e vjetëruara eliminohen dhe zëvendësohen me variante të tjera të mundshme ose bëhet modifikimi i tyre. Hartohet gjithashtu një listë për të identifikuar gjendjen e revizionimit të dokumenteve në përdorim, për të evituar përdorimin e dokumenteve të papërshtatshme.

Prodhuesi duhet të ketë një procedurë të dokumentuar, për të garantuar që materialet përbërëse janë konform kërkesave të pikës 4 të S SH EN 197 - 1 dhe të përshtatshëm për të siguruar prodhimin e çimentos.

Manuali i cilësisë përshkruan dhe dokumenton parametrat e zgjedhur për prodhimin, kontrollin e provave gjatë procesit, si dhe frekuencën e tyre.

Përshkruhen në mënyrë të mjaftueshme teknikat e kontrollit të cilësisë të fabrikës, procedurat

dhe operacionet sistematike që janë zbatuar.

Prodhuesi zbaton dhe dokumenton një sistem provash të autokontrollit. Kriteret e konformitetit dhe plani i marrjes së kampionit i përgjigjen rregullores. Frekuenca e provave të autokontrollit nuk është më e ulët se ajo e treguar në tabelën 1, ose përsa i përket fazës fillestare për një tip të ri çimentoje në kolonën 5 (prova fillestare). Vetitë që përcaktohen në prova, për çdo tip dhe klasë çimentoje, janë ato të treguara në kolonat 1 dhe 2 të tabelës 1 dhe metodat e provave të përdorura, tregohen në kolonën 3 të tabelës 1. Për ato çimento për të cilat shpërndarja nuk është e vazhdueshme, frekuenca e provave dhe e marrjes së kampioneve është e përcaktuar në manualin e cilësisë së fabrikës. Të gjitha të dhënat e marra nga provat dokumentohen dhe janë të disponueshme për një kontroll në vazhdim nga organizmi i autorizuar.

Prodhuesi i ruan rezultatet e kontrollit të prodhimit të fabrikës dhe të provave të autokontrollit për një periudhë të paktën 3-vjeçare.

Aparaturat për kontrollin dhe provat në fazën e prodhimit, verifikohen rregullisht dhe tarohen sipas mënyrës së përcaktuar në manualin e cilësisë, si dhe në përputhje me ligjin nr. 8996, datë 30.01.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse”.

Në manualin e cilësisë pasqyrohen të gjitha procedurat e zbatuara nga prodhuesi për gjendjen e kontrollit dhe të provave në të gjitha fazat e prodhimit.

5. Kontrolli i qendrës së shpërndarjes. Detyrimet e ndërmjetësit

Drejtuesi i qendrës së shpërndarjes është përgjegjës për kontrollin e dokumenteve dhe të dhënave që lidhen me kontrollin e kryer në qendrën e shpërndarjes, në përputhje me standardet e përshkruara në rregullore.

Ky kontroll duhet të sigurojë që dokumentet të jenë tërësisht të disponueshme, dokumentet e papërdorshme të hiqen nga qarkullimi dhe ndryshimet ose modifikimet e çdo dokumenti të bëhen të njohura.

Me qëllim që të parandalohet përdorimi i dokumenteve të papërdorshme duhet të hartohet një listë kryesore në mënyrë që të identifikohen versionet aktuale të dokumenteve.

Sistemi i kontrollit të cilësisë parashikon një sistem të përshtatshëm provash për pranimin dhe identifikimin, që synon të vërtetojë që çimentoja rifuxho e marrë në qendrën e shpërndarjes nuk ka pësuar ndryshime si pasojë e ndotjes, vjetërimit dhe që kjo i korrespondon çimentos së specifikuar në kontratat e blerjes. Identifikimi garantohet duke marrë një kampion për çdo parti të lëvruar, me të paktën një kampion për çdo 500 ton çimento të marrë.

Mbi këto kampione kryhen provat e dhëna në tabelën 2.

Vetia që përcaktohet për një identifikim të shpejtë (imtësia, H/K, ngjyra etj.), zgjidhet nga ndërmjetësi me një aprovim paraprak nga organizmi i autorizuar.

Ndërmjetësi dokumenton se ka një sistem provash të autokontrollit. Autokontrolli i kryer mbi kampionet e çimentos ka si qëllim të sigurojë që çimentoja i ka ruajtur vetitë e saj.

Frekuenca e marrjes së kampioneve dhe kryerjes së provës, karakteristikat që duhet të kontrollohen dhe metodat e provave, i korrespondojnë atyre të dhëna në tabelën 2. Rezultatet e provave të autokontrollit të kryera në qendrën e shpërndarjes ballafaqohen dhe krahasohen me të dhënat që merren nga fabrika që furnizon çimenton. Autokontrolli kryhet në laboratorin e ndërmjetësit ose në një laborator të akredituar.

Ndërmjetësi i ruan të dhënat e kontrollit në faza të ndryshme për një periudhë të paktën 3-vjeçare.

Aparaturat për kontrollin dhe provat në fazën e marrjes dhe të transportit prej ndërmjetësit, verifikohen rregullisht dhe tatohen sipas mënyrës së përcaktuar në manualin e cilësisë dhe në përputhje me ligjin nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse”.

Në manualin e cilësisë përcaktohet një laborator provash i akredituar për një ballafaqim të rezultateve, nëse paraqitet nevoja.

Në manualin e cilësisë pasqyrohen të gjitha procedurat e zbatuara nga ndërmjetësi për gjendjen e kontrollit dhe të provave në fazat e marrjes dhe të dorëzimit.

6. Administrimi i moskonformitetit dhe veprimet korrigjuese të prodhuesit

Në manualin e cilësisë raportohen veprimet e zbatuara në rastin e mospërputhjes së specifikimeve të brendshme të përcaktuara nga prodhuesi.

Në rastin kur rezultatet e provave për një çimento nuk rezultojnë brenda vlerave limite të treguara në tabelën 5, menjëherë prodhuesi përcakton sasinë, ndërmerr një veprim të përshtatshëm për bllokimin e shpërndarjes së kësaj sasive dhe njofton klientin në rastin kur çimentoja është shpërndarë. Veç kësaj, prodhuesi stabilizon menjëherë shkaqet e moskonformitetit, duke ndërmarrë masat e nevojshme korrigjuese për një korrigjim të të gjithë procedurës së kontrollit të fabrikës. Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe rezultatet dokumentohen.

Manuali i cilësisë përshkruan me detaje procedurën për korrektimin e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë në rastin e moskonformitetit të rezultateve. Veprimet e ndërmarra dokumentohen në kohën e duhur. Konsiderohen veprime korrigjuese edhe modifikimet e bëra në sistemin e kontrollit të cilësisë mbas sinjalizimit të bërë nga organizmi i autorizuar.

7. Administrimi i moskonformitetit dhe veprimet korrigjuese të ndërmjetësit

Ndërmjetësi demonstroi përputhshmërinë e karakteristikave të produktit të shitur me karakteristikat e produktit të markuar në origjinë. Në rastin kur çimentoja paraqet një rezultat prove që nuk korrespondon me karakteristikat ose nuk është konform kërkesave të S SH EN 197-1, menjëherë ndërmjetësi përcakton sasinë, ndërmerr një sërë veprimesh që bllokojnë shpërndarjen e kësaj sasive çimentoje dhe informon prodhuesin, organizmin që ka lëshuar dëshminë e konformitetit, si edhe klientin, nëse çimentoja është shitur.

Ndërmjetësi ndërkaq stabilizon menjëherë shkaqet e mospërputhjes dhe moskonformitetit dhe nëse këto varen nga qendra e shpërndarjes, ndërmerr veprimet korrigjuese dhe bën një korrigjim të të gjitha procedurave të kontrollit.

Të gjitha veprimet e ndërmarra dhe rezultatet dokumentohen.

8. Lëvizja, magazinimi, ambalazhi, shitja dhe hetimi. Detyrimet e prodhuesit ose të ndërmjetësit

Manuali i cilësisë përshkruan kushtet paraprake të vendosura për të siguruar ruajtjen e cilësisë së çimentos deri sa kjo të jetë nën përgjegjësinë e prodhuesit ose të ndërmjetësit.

Dokumenti që shoqëron mallin mund të verifikohet në qendrën e prodhimit ose të shpërndarjes. Pikërisht ky kusht është kërkesë edhe në rastin e depozitave të çimentos rifuxho, të cilat administrohen nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit.

9. Kualifikimi. Përgjegjësitë e prodhuesit ose të ndërmjetësit

Manuali i cilësisë përmban procedurat që prodhuesi ose ndërmjetësi përdor për të garantuar se i gjithë personeli që merr pjesë në operacionet që mund të influencojnë në kontrollin e prodhimit, ka eksperiencën dhe kualifikimin e përshtatshëm.

Dokumentacioni përkatës ruhet.

10. Përdorimi i markës së konformitetit

Ndërmjetësi autorizohet të përdorë markën e konformitetit të vendosur nga prodhuesi, kur rezultatet e provës së autokontrollit në qendrën e shpërndarjes dhe ato të organizmit të autorizuar mbi kampionet e marra, janë konform standardeve. Rezultatet e provave të autokontrollit konfirmues për çdo çimento të certifikuar të kryer nga ndërmjetësi, duhet të mbeten brenda intervalit të vlerave maksimale dhe minimale të rezultateve të provave të autokontrollit të kryera nga prodhuesi në fabrikë në 12 muajt paraardhës. Kur rezultatet nuk korrespondojnë me kërkesat, autorizimi dhe mbajtja e përdorimit të markës së konformitetit bazohet në një verifikim rast pas rasti nga ana e organizmit të autorizuar.

PJESA II PRO PËR DHËNIEN E DËSHMISË SË KONFORMITETIT

1. Hyrje

Prodhuesi ose shpërndarësi bashkëpunojnë me organizmat e autorizuar për vlerësimin e konformitetit sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”, për të lejuar inspektim e tyre në fabrikë dhe në sistemin e kontrollit të prodhimit. Prioritet i jepet kontrollit të prodhimit.

Detyrimet e përshkruara kryhen pa vonesë duke i dhënë prioritet kontrollit të produktit.

Prodhuesi për çdo qendër të veçantë, ndër të tjera, përcakton në manualin e cilësisë:

- tipet e çimentos së prodhuar dhe shënjat korresponduese të njohjes (thasë ose kartela identifikimi);
- përshkrimin e impianteve të prodhimit dhe të shpërndarjes;
- vendndodhjen e mundshme të depozitave të administruara nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit;
- përshkrimin e ambienteve dhe pajisjeve të provave, të nevojshme për provat e brendshme të autokontrollit;
- listën e depozitave;
- organizimin e kontrollit të brendshëm të cilësisë;
- personat përgjegjës të ngarkuar nga firma për kontrollin e brendshëm në fabrikë;
- një deklaram që vërteton se shërbimi i verifikimit inspektiv të sistemit të cilësisë është i pavarur nga shërbimi i prodhimit.

Manuali i cilësisë dhe rishikimet e njëpasnjëshme të tij, i dorëzohen organizmit të autorizuar, që angazhohet t'i mbajë të rezervuara.

2. Inspektimi fillestar i fabrikës dhe i sistemit të cilësisë

2.1. Inspektimi i një fabrike të re

Organizmi i autorizuar kryen një verifikim fillestar të fabrikës dhe të sistemit të kontrollit të cilësisë së produktit të zbatuar nga fabrika. Në fund organizmi i autorizuar:

- a) konfirmon që sistemi i kontrollit të cilësisë së fabrikës është sipas procedurave të përshkruara në pjesën I dhe se ky sistem funksionon;
- b) vlerëson që impianti i përdorur për prodhim dhe pajisjet e përdorura për kontrollin e çimentos janë konform kritereve të përcaktuara në pikat 2, 3 të pjesës II.

2.2. Inspektimi i një fabrike ekzistuese

Në rastin e prodhimit të një tipi të ri ose klase të re rezistence të çimentos në një fabrikë ekzistuese, organizmi i autorizuar, vendos në bazë të modifikimeve të paraqitura në manualin e cilësisë së fabrikës dhe të komunikuar nga fabrika, nëse është i nevojshëm një inspektim shtesë.

Në rast se duhet, organizmi i autorizuar ekzaminon çdo novacion që ka shkaktuar modifikime thelbësore në procedurën për kontrollin e procesit të prodhimit dhe vërteton që ai është kryer sipas kritereve të dhëna në rregullore.

2.3. Kriteret për vlerësimin e impiantit të prodhimit

Organizmi i autorizuar vlerëson përshtatshmërinë e impiantit të prodhimit në lidhje me manualin e cilësisë dhe përshtatshmërinë e tij për të prodhuar çimento, që kënaq kërkesat e parashikuara nga ligji nr.9290, datë 7.10.2004 "Për produktet e ndërtimit".

Vlerësimi, veç të tjerave, verifikon nëse:

- a) materialet përbërëse që do të përdoren për prodhimin e çimentos, janë të mbrojtura prej ndotjes;
- b) disponohen impiante të përshtatshme për prodhimin e vazhdueshëm në masë të çimentos, në veçanti për një prodhim të mjaftueshëm dhe depozitim të përshtatshëm; këto impiante lejojnë kontrollin e cilësisë me një siguri të mjaftueshme për të garantuar kërkesat e përshkruara;

- c) janë marrë masa për të parandaluar ndotjen e çimentos gjatë transportit dhe depozitimit;
- d) çdo çimento është e depozituar në një ose më shumë silose të ndara; mbi silos shënohet në mënyrë të qartë tipi i çimentos, klasa e rezistencës dhe çdo informacion shtesë i nevojshëm;
- e) në pikat e shpërndarjes së çimentos nga fabrika lejohen marrje të kampioneve sipas metodave të mostrimit të përshkruara në S SH EN - 196.

2.4. Kriteret për vlerësimin e laboratorëve

a) Laboratori përgjegjës për kryerjen e provave të kërkuara prej sistemit të kontrollit të cilësisë në fabrikë, disponon pajisje të nevojshme për kryerjen e provave të parashikuara në manualin e cilësisë.

b) Laboratori përgjegjës për kryerjen e provave të autokontrollit disponon pajisjet e nevojshme për kryerjen e provave të listuara në standardin specifik të produktit përkatës (tabelat në fund të rregullores), duke përdorur metoda provash të përcaktuara ose ekuivalente.

2.5. Raporti i inspektimit

Inspektimi fillestar dokumentohet nën titullin “Raport inspektimi”, që ruhet në dokumentet e prodhuesit.

3. Provat fillestare mbi çimentot

Provat fillestare mbi çimentot, përfshijnë rezultatet e provave të kontrollit inspektiv të jashtëm, që kryhen gjatë periudhës fillestare, zgjatja e së cilës është 3 muaj, në marrëveshje me organizmin e autorizuar.

Numri i kampioneve të kontrollit inspektiv fillestar dhe periudha brenda së cilës merren këto kampione, përcaktohet në marrëveshje me prodhuesin dhe organizmin e autorizuar. Marrja e kampioneve dhe provat kryhen siç tregohet më poshtë.

Vlerësimi i provave fillestare të çimentos, bazohet si mbi rezultatet e provave të autokontrollit, ashtu edhe mbi rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm inspektiv të marra në periudhën fillestare. Duke kryer vlerësimin, organizmi i autorizuar harton një raport inspektimi që i bashkëngjitet akteve të prodhuesit.

4. Vlerësimi, miratimi dhe mbikëqyrja e kontrollit të prodhimit

Organizmi i autorizuar kryen vlerësimin, miratimin e sistemit të kontrollit të prodhimit zbatuar nga prodhuesi në fabrikë, për të përfutur produkte sipas ligjit nr.9092, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”.

Organizmi i autorizuar kryen funksionet e veta, si më sipër, të paktën një herë në vit dhe me paralajmërim.

Në vijim të çdo vizite kontrolli, organizmi i autorizuar harton një raport inspektimi që është posaçërisht për drejtuesin e fabrikës, i cili parashikon të gjitha veprimet korrigjuese që duhen ndërmarrë si rezultat i verifikimit.

Zbatimi i veprimeve korrigjuese i komunikohet nga prodhuesi organizmit të autorizuar.

5. Vlerësimi i rezultateve të provave mbi kampionet e autokontrollit

Organizmi i autorizuar verifikon nëse rezultatet e autokontrollit të prodhuesit kënaqin kërkesat e standardit.

Numri i verifikimeve statistikore të kryera nga organizmi i autorizuar, mbi të dhënat në periudhën e kontrollit, është nga 1 deri 3 në vit dhe kryhet sipas marrëveshjeve paraprake.

Periudha e kontrollit është 12 muaj ose e barabartë me periudhën fillestare në rastin e një tipi të ri çimentoje.

Vlera karakteristike është ajo e rendit 0.05 për limitin e poshtëm të rezistencës mekanike dhe e rendit 0.10 për limitet e tjera të rezistencës mekanike, llogaritur sipas shprehjes:

$$f_k = f_m - k S_s$$

$$f_k = f_m + k \text{ (për limitin e sipërm të rezistencës mekanike) ku:}$$

$$f_m = \text{mesatarja aritmetike e } n \text{ rezultateve;}$$

$$S_s = \text{shmangia kuadratike mesatare e } n \text{ rezultateve;}$$

k - faktor i përcaktuar në tabelën 6 të shtojcës 3, në funksion të numrit të rezultateve eksperimentale dhe të përqindjes së popullatës dhe formulimit të rrezikut të tipit 1-a me mbrojtje të njëanshme ku:

= 5% për limitin e poshtëm të rezistencës mekanike;

= 10% për limitin e sipërm të rezistencës mekanike.

Vlerat karakteristike të llogaritura në këtë mënyrë, respektojnë limitet e tabelës 3.

Në alternative përpunohen rezultatet e karakteristikave kimike e fizike (shih S SH EN 197 - 1, pika 9, 5, 2) duke pasur parasysh numurin nD të rezultateve defekte të çdo tip prove, në serinë complete të kampioneve të kontrolluara. Duhet që:

$$nD \leq nA$$

ku nA është numri i pranueshëm i defekteve = 10% që është në funksion të numrit n të rezultateve të provës që jepet nga tabela 7.

Në rastin kur disa tipe e klasa çimentosh nuk janë shpërndarë në mënyrë të vazhdueshme, frekuencat e mësipërme dhe pikat e marrjes së kampioneve variojnë sipas marrëveshjes paraprake mes organizmit të autorizuar dhe prodhuesit.

6. Provat

Çdo kampion homogjenizohet dhe ndahet në 3 nënkampionë.

Metodat e marrjes së kampionëve duhet të plotësojnë kërkesat sipas S SH EN 196/7.

Një nënkampion trajtohet nga prodhuesi për provat dhe një tjetër ambalazhohet, identifikohet saktësisht nga organizmi i autorizuar dhe dërgohet në një laborator të akredituar në formë anonime.

Nënkampioni i tretë vutose me vula të të dy palëve dhe ruhet nga prodhuesi për një periudhë minimumi tre muaj dhe përdoret në rastet kur:

- a) një nga kampionët e parë humbet, dëmtohet ose ndotet;
- b) në rast kundërshtimesh janë të nevojshme prova të tjera.

Prishja e vulës së nënkampionit të fundit kryhet nga organizmi i autorizuar dhe, nëse kërkohet, në prani të një përfaqësuesi të prodhuesit të deleguar posaçërisht.

Të dy nënkampionët e parë provohen respektivisht nga prodhuesi dhe organizmi i autorizuar, për cilësitë e çdo tipi dhe klase të çimentos listuar në kolonën 1 dhe 2 të tabelës 1, duke përdorur metodat e provave sipas kolonës 3 të tabelës 1.

6.1. Vlerësimi i rezultateve të provave

Organizmi i autorizuar vërteton që:

- rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm nuk janë nën vlerat limite të treguara në tabelën 5;

- ripërpunimi statistikor i rezultateve të provave të brendshme të autokontrollit çon në vlera karakteristike korresponduese me limitet e dhëna në tabelën 3 dhe 4;

- ka përputhje midis rezultateve të provave të autokontrollit të brendshëm dhe atyre të kontrollit të jashtëm sipas procedurës së shtojcës A.

Kur verifikimet e mësipërme rezultojnë negative, organizmi i autorizuar zbaton masat e tabelës 8.

7. Inspektimi fillestar i qendrës së shpërndarjes dhe i sistemit të cilësisë

7.1. Inspektimi i një qendre të re shpërndarje

Organizmi i autorizuar kryen një verifikim fillestar të qendrës së shpërndarjes dhe sistemit të cilësisë.

Me këtë inspektim organizmi i autorizuar:

- a) konfirmon që procedurat për kontrollin e cilësisë së shpërndarjes janë sipas rregullores;
- b) verifikon që impianti është i përshtatshëm për ruajtjen e cilësisë së çimentos. Inspektimi përfshin kontrollin e sistemit të shkarkimit, impiantin e vendosjes në depozitë, sistemin e marrjes nga depozita dhe të ngarkimit dhe laboratorin. Veçanërisht i kushtohet rëndësi procedurave për evitimin e destinacionit të gabuar të çimentos ose ndotjen midis çimentove të ndryshme.

7.2. Inspektimi i një qendre shpërndarje ekzistuese

Në rastin e shpërndarjes së një tipi apo klase të re çimentoje nga një qendër shpërndarje ekzistuese, organizmi i autorizuar vendos në bazë të modifikimeve të bëra në manualin e cilësisë së impiantit të shpërndarjes, nëse është i nevojshëm një inspektim i veçantë. Në rast se po, organizmi i autorizuar vlerëson se cili nga verifikimet e procedurave është sipas kritereve të pikave 7.3 e 7.4.

7.3. Kriteret për vlerësimin e qendrës së shpërndarjes

Organizmi i autorizuar vlerëson përshtatshmërinë e qendrës së shpërndarjes në lidhje me procedurat dhe kërkesat e mëposhtme:

- a) praninë e një laboratorit në qendrën e shpërndarjes ose marrëveshjen me një laborator të akredituar, për të kontrolluar që një çimento rifuxho e marrë nuk ka pësuar ndryshime dhe i korrespondon çimentos së specifikuar në kontratat e blerjes;
- b) marrjen e masave të përshtatshme për të parandaluar ndotjen e çimentove të ndryshme gjatë furnizimit, transportit e depozitimit;
- c) magazinimin e çdo çimentoje në një apo me tepër sillose të ndara. Mbi çdo sillos vendoset qartë shënimi për tipin dhe klasën e rezistencës së çimentos, adresat e prodhuesit dhe të fabrikës, si dhe informacione të tjera shtesë.

d) trajtimin e përshtatshëm në pikat e shpërndarjes së çimentos, sipas metodave të përshkruara

në S SH EN 196/7

7.4. Kriteret e vlerësimit të laboratorëve

Përshtatshmëria e laboratorëve vendoset në bazë të karakteristikave të mëposhtme:

a) provat e përcaktuara në manualin e cilësisë kryhen në laboratorët e brendshëm me kushtet dhe pajisjet që parashikon standardi, ose në mungesë të tyre, në laboratorë të jashtëm të akredituar;

b) laboratori që kryen provat e autokontrollit të disponojë të paktën pajisjet e nevojshme për kryerjen e provave mbi vetitë e dhëna në tabelën 2, duke përdorur metodat e provave të përcaktuara, ose metoda ekuivalente.

7.5. Raporti i inspektimit

Organizmi i autorizuar në bazë të një raporti specifik vë në dijeni drejtuesin e qendrës së shpërndarjes për vendimin rreth mbajtjes së markës së konformitetit, në përputhje me pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.723, datë 5.11.2004 “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen dhe vlerësimin e konformitetit”.

8. Vlerësimi, miratimi dhe mbikëqyrja e sistemit të kontrollit të qendrës së shpërndarjes

8.1. Detyrat e organizmit të autorizuar

Organizmi i autorizuar kryen vlerësimin, mbikëqyrjen e sistemit të kontrollit të cilësisë së zbatuar nga ndërmjetësi, si dhe i jep ose i heq qendrës së shpërndarjes të drejtën e përdorimit të markës së konformitetit.

8.2. Frekuenca e inspektimeve

Organizmi i autorizuar kryen verifikimet e mësipërme të paktën një herë në vit, duke lajmëruar paraprakisht drejtuesin e qendrës së shpërndarjes.

8.3. Raporti i inspektimit

Në vijim të çdo vizite kontrolli, organizmi i autorizuar përgatit një raport që ia dërgon drejtuesit të qendrës së shpërndarjes.

Përfaqësuesi i drejtuesit të qendrës së shpërndarjes informon organizmin e autorizuar për çdo veprim korrigjues të ndërmarrë ose të programuar si rezultat i raportit të kontrollit dhe nëse këto veprimet kanë qenë efektive apo jo.

9. Vlerësimi i rezultateve të provave në kampionet e autokontrollit për vërtetim

Organizmi i autorizuar verifikon nëse rezultatet e autokontrollit në qendër kënaqin kriteret e konformitetit të S SH EN 197 - 1 dhe që vlerat e marra nuk ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme nga vlerat e autokontrollit të kryer në fabrikën që furnizon çimenton.

Numri i verifikimeve statistikore mbi të dhënat relative në periudhën e kontrollit nuk është më i ulët se një verifikim në vit.

Periudha e kontrollit është 12 muaj.

Çdo vlerësim kryhet mbi totalin e rezultateve të provave të autokontrollit të marra gjatë 12 muajve paraardhës nga data e verifikimit.

Rezultatet e provave të autokontrollit të kryera në fabrikën që furnizon çimenton dhe ato të kryera në qendrën e shpërndarjes, vlerësohen nga organizmi i autorizuar në afate të rregullta.

10. Provat mbi kampionet e kontrollit të jashtëm inspektiv të marra pranë qendrës së shpërndarjes

10.1. Marrja e kampionit

Kampionet merren kryesisht për të kryer një kontroll për saktësinë e rezultateve të provave të marra nga laboratorit i qendrës së shpërndarjes. Kampionet e sakta merren nën përgjegjësinë e organizmit të autorizuar, në pikën ose pikat e dorëzimit të çimentos, nga qendra e shpërndarjes ose nga ngarkesat e nisura për konsum.

Në fund të marrjes së kampioneve përfaqësuesit të organizmit të autorizuar i lejohet hyrja në çdo moment, pa paralajmërim, në qendrën e shpërndarjes.

10.2. Numri i kampioneve

Numri i kampioneve të marra në një vit nuk është më pak se 3 për çdo tip e klasë rezistence të çimentos së shpërndarë nga qendra e shpërndarjes.

10.3. Provat

Çdo kampion homogjenizohet dhe ndahet në tre nënkampione.

Metodat e marrjes së kampionëve të përdorur për marrjen dhe përgatitjen e kampionëve plotësojnë kërkesat e S SH EN - 196 - 7.

Një nënkampion trajtohet nga qendra e shpërndarjes për provat dhe një tjetër ambalazhohet dhe identifikohet qartë, nën kujdesin e organizmit të autorizuar dhe nga këtu dërgohet në një laborator të akredituar në formë anonime.

Nënkampioni i tretë vulosem dhe ruhet nga qendra e shpërndarjes për një periudhë minimumi 3 muaj dhe përdoret në rastet kur:

- a) një nga dy nënkampionët humbet, dëmtohet ose ndotet;
- b) janë të nevojshme prova shtesë në rast mospërputhjes.

Përdorimi i nënkampionit të fundit kryhet nën kujdesin e organizmit të autorizuar në prezencë, nëse kërkohet, të një përgjegjësi të qendrës së shpërndarjes.

Dy nënkampionet e para provohen respektivisht nga qendra e shpërndarjes dhe organizmi i autorizuar, për vetitë e çdo tipi e klase çimentoje, të cilësuar në kolonat 1 dhe 2 të tabelës 2, duke përdorur metodat e provave të përcaktuara në kolonën 3 të tabelës 2.

11. Dëshmia e konformitetit

11.1. Të përgjithshme

Konformiteti i një çimentoje me standardet tregohet në një dëshmi konformiteti.

Dëshmia e konformitetit lëshohet nga organizmi i autorizuar, i cili e kryen veprimtarinë e tij mbështetur në vendimin nr.723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”, që i lejon prodhuesit të përdorë markën e konformitetit.

Të gjitha procedurat deri në lëshimin e dëshmisë së konformitetit e më pas, organizmi i autorizura i kryen mbështetur në aktet e mësipërme.

Kur prodhimi i një produkti për të cilin është dhënë dëshmia e konformitetit ndërpritet, prodhuesi njofton organizmin e autorizuar brenda 15 ditëve nga data e ndërprerjes. Organizmi i autorizuar në këtë rast e pezullon dëshminë e konformitetit për një periudhë jo më shumë se 6 muaj. Me rifillimin e prodhimit, dëshmia rivendoset vetëm nëse provat mbi kampionët e marrë dalin pozitive.

Nëse bëhet fjalë për prodhimet stinore (shitur për një periudhë kohe të vitit 3-6 muaj në vazhdim), dëshmia e konformitetit lëshohet për herë të parë, siç parashikohet në rregullore. Organizmi i autorizuar dhe prodhuesi merren vesh për frekuencën e autokontrollit. Në periudhën e prodhimit organizmi i autorizuar kryen të paktën 3 marrje kampioni. Për vitet në vijim, dëshmia e parë jepet vetëm nëse provat mbi kampionët e parë të marrë nga jashtë dalin pozitive. Prodhuesi informon organizmin e autorizuar për zgjatjen e supozuar të prodhimit stinor dhe regjistron fillimin e shpërndarjes të paktën 30 ditë para fillimit të vetë shpërndarjes ose përfundimin e tyre brenda 15 ditëve nga vetë përfundimi.

Organizmi i autorizuar azhurnon listën e dëshmive të lëshuara, listë e cila i dërgohet çdo vit Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Policisë së Ndërtimit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

11.2. Dhënia e dëshmisë për produkte të veçanta

Veç një tipi ose klase rezistence të caktuar të çimentos, e cila prodhohet në një fabrikë për të cilën prodhuesi ka marrë dëshmi konformiteti në të njëjtën fabrikë mund të prodhohet çimento e veçantë që ka përbërje, veti fizike ose kimike, ose rezistencë në shtypje të ndryshme dhe për të cilën prodhuesi kërkon që të vlerësohet, certifikohet dhe identifikohet si çimento e ndryshme. Në këtë rast dëshmia e konformitetit jepet në bazë të provave të autokontrollit dhe kampioni i parë për provat e kontrollit të organizmit të autorizuar analizohet nga laboratori i provave.

11.3. Ndërprerja e prodhimit

Prodhuesi i cili ndërpret përfundimisht prodhimin e një tipi të veçantë çimentoje ose të një klase të caktuar të rezistencës, informon organizmin e autorizuar, i cili e anulon dëshminë e konformitetit.

11.4. Certifikata SL e konformitetit dhe deklarata SL e konformitetit

Në rastin kur shihet që është plotësuar sistemi i vërtetimit të konformitetit sipas paragrafit 7 të S SH EN 197 —2, trupi certifikues lëshon një certifikatë konformiteti SL, me informacionin e treguar më poshtë. Kjo certifikatë i jep të drejtë prodhuesit që të vendosë markën SL (sipas ligjit).

Certifikata e konformitetit SL do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Emrin dhe adresën e trupit certifikues.
 - Emrin dhe adresën e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar dhe vendin e prodhimit.
 - Përshkrimin e produktit (emërtimi standard i çimentos sipas S SH EN 197 — 1 dhe ndonjë identifikim tjetër shtesë i kërkuar).
 - Kushtet që duhet të plotësojë produkti (shtojca ZA e S SH EN 197 — 1, në konformitet sipas S SH EN 197 — 2, siç jepet në shtojcën ZA të S SH EN 197—1).
 - Kushte të veçanta të zbatueshme gjatë përdorimit të produktit (asnjë lidhur me konformitetin).
 - Numrin e certifikatës.
 - Kushtet dhe periudhën e vlefshmërisë së certifikatës, atje ku ajo është e zbatueshme.
 - Numrin dhe pozicionin e mbajtur nga personi i cili firmos certifikatën.
- Veç këtyre, për çdo produkt që përfaqësohet nga një certifikatë e konformitetit SL, prodhuesi duhet të lëshojë një deklaratë konformiteti, që përfshin informacionin e mëposhtëm:
- Emrin dhe adresën e prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.
 - Numrin e certifikatave të konformitetit SL të marra.
 - Emrin dhe pozicionin e personit që firmos deklaratën në emër të prodhuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

11.5. Vendorsja e markës SL të konformitetit

11.5.1. Çimentoja e paketuar në thasë

Në rastin e çimentove të paketuara në thasë, vendorsja e shenjës së konformitetit SL, numrit të identifikimit të organit certifikues dhe çdo informacion tjetër shoqërues që tregohet më poshtë, duhet të vendoset mbi thes ose në dokumentet tregtare shoqëruese, ose në një kombinim të tyre. Nëse mbi thes nuk shënohet i gjithë informacioni, por veç një pjesë e tij, atëhere informacioni i plotë duhet të jepet në dokumentet tregtare shoqëruese.

SL

0123

Ndonjë kompani

Adresa e regjistruar

Fabrika 4

Viti 01

(ose data e vulosjes)

01 23-C PD-0456

S SH EN 197-1

CEM 1 42,5R

Informacion shtesë

SL — Vendosja e shenjës së konformitetit SL konsiston në simbolin “SL” sipas vendimit nr.723, datë 5.11.2004 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat bazë të funksionimit të organizmit të autorizuar për kryerjen e vlerësimit të konformitetit”.

0123 - Numuri i identifikimit të organit certifikues

Ndonjë kompani — emri ose shenja identifikuese e prodhuesit

Adresa e regjistruar — Adresa e regjistruar e prodhuesit

Viti 01 — Dy shifrat e fundit të vitit në të cilën është vendosur marka

0123 — CPD — 0456 - Numri i certifikatës SL të konformitetit

S SH EN 197-1 — Numri i standardit europian

CEM 1 42,5 R — Shembulli i një emërtimi standard që tregon produktin e çimentos dhe klasën e rezistencës, siç jepet në paragrafin 8 të S SH EN 197—1

Informacion shtesë:

Limiti për kloruret në % - Vetëm kur çimento e zakonshme e prodhuar ka një përmbajtje limit kloruresh të ndryshme nga vlera e përcaktuar në tabelën 3 të S SH EN 197 -1.

Limiti për humbjet në kalcinim të hirit fluturues në % - Vetëm kur në lidhje me 5.2.4.1 të S SH EN 197-1, është përdorur hi fluturues me humbjet në kalcinim në kufijtë nga 5% - 7%.

Shënim standard për shtesat — Vetëm kur në lidhje me 5.5 të S SH EN 197-1, është përdorur një përzjerje në përputhje me serinë EN 934.

Për arsye praktike mund të zgjidhet ndonjë nga alternativat e mëposhtme, për të paraqitur informacionin mbi thasët e çimentos:

a) Kur mbi thes tregohet vetëm shenja SL, atëhere elementet e mëposhtme të informacionit shoqërues, jepen në dokumentet tregtare shoqëruese në vend që të jepen mbi thes:

- emri ose shenja identifikuese e fabrikës
- viti i vendosjes së shenjës SL,
- numri i certifikatës së konformitetit SL,
- informacion shtesë.

b) Në rastin kur dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur shenja SL janë stampuar me parë mbi thes, ky i fundit shoqërohet me datën e saktë të vendosjes së shenjës ± 3 muaj.

c) Në rastin kur dy shifrat e fundit të vitit në të cilin është vendosur shenja nuk janë stampuar më parë mbi thes, atëhere këto do të vendosen me anën e një stampuesi datash në një vend të dukshëm të qartë. Ky vend tregohet në informacionin shoqërues.

Produkti duhet të shoqërohet në formë të përshtatshme, me një dokumentacion ku jepet ndonjë legjislacion për substancat e dëmshme për të cilat kërkohet aprovim, së bashku me ndonjë informacion të kërkuar nga ai legjislacion, kur dhe ku kërkohet.

11.5.2. Çimentoja rifuxho

Në rastin e çimentos rifuxho, vendosja e markës SL të konformitetit, numrit të identifikimit SL, numrit të identifikimit të organit certifikues dhe informacionit shoqërues siç jepet për çimentot e paketuara në thasë (11.5.1), bëhet në një formë të përshtatshme në dokumentet tregtare shoqëruese.

11.6. E drejta e përdorimit të markës së konformitetit

Ndërmjetësi i cili administron qendrën e shpërndarjes dhe që plotëson detyrimet që rrjedhin nga pikat paraardhëse, përdor markën e konformitetit në produktet e shpërndara, pas autorizimit të prodhuesit përkatës dhe organizmit të autorizuar, i cili ka dhënë dëshminë e konformitetit për produktet përkatëse.

12. Procedura në rastin e moskonformitetit

12.1. Përgjegjësia e prodhuesit

Veprimet korrigjuese që ndërmerren në rast të një moskonformiteti, kryhen nën përgjegjësinë e plotë të prodhuesit, i cili dokumenton aktivitetin që kryen në mënyrë të detajuar dhe ia paraqet organizmit të autorizuar.

13. Veprimet e organizmit të autorizuar ndaj prodhuesit

13.1. Kontrolli i prodhimit dhe autokontrolli

Organizmi i autorizuar ndërmerr veprime eventuale ndaj prodhuesit për shkak të vlerësimit, aprovimit dhe mbikëqyrjes së sistemit të cilësisë së prodhimit dhe të vlerësimit të rezultateve të

provave të autokontrollit, në bazë të vlerësimit rast për rast të raporteve relative. Në rast se rezultatet e provave të autokontrollit të prodhuesit tregojnë se kriteret e konformitetit nuk janë plotësuar, veprimet që ndërmerri organizmi i autorizuar janë ato të treguara në tabelën 8.

13.2. Kontrolli i jashtëm

1. Nëse kontrollet e kryera tregojnë diferenca për shkak të gabimeve të kampionit ose të provës, identifikohen arsyet. Organizmi i autorizuar përcakton nëse janë ndërmarrë veprimet e përshtatshme për korrigjimin e këtyre diferencave dhe tregon veprimet e mundshme të mëtejshme, në mënyrë që të korrigjohen të gjitha rezultatet relative.

2. Nëse rezultatet e kontrollit të jashtëm inspektiv japin rezultate të provave jashtë vlerave karakteristike, organizmi i autorizuar vlerëson rezultatet e provave të autokontrollit të prodhuesit për një periudhë të mjaftueshme dhe jo më pak se 12 muaj dhe njofton organizmin e certifikimit. Nëse provat e autokontrollit janë të kënaqshme nuk ndërmerren veprime të tjera. Nëse provat e autokontrollit tregojnë moskonformitet statistikor, organizmi i autorizuar ndërmerri veprimet e parashikuara në tabelën 8.

3. Nëse rezultatet e provave të kontrollit të jashtëm inspektiv nuk kënaqin kërkesat e parashikuara për vlerat limite (tabela 3), organizmi i autorizuar ndërmerri veprimet e parashikuara në tabelën 8.

4. Rezultatet e provave të përmendura më sipër në pikat 2 e 3, janë ato të marra pas realizimit të ndërhyrjeve të mundshme korrigjuese sipas pikës 1.

13.3. Përgjegjësia e ndërmjetësit

Veprimet korrigjuese që ndërmerren në rast të një moskonformiteti pranë qendrës së shpërndarjes, kryhen nën përgjegjësinë e plotë të ndërmjetësit, i cili dokumenton aktivitetin e kryer në mënyrë të hollësishme dhe të miratuar nga organizmi i autorizuar.

13.4. Veprimet e organizmit të autorizuar ndaj ndërmjetësit

Kushtet e pikave 13.1 dhe 13.2 që i referohen fabrikave vlejnë edhe për qendrat e shpërndarjes, përveç veprimeve që ndërmerren nga organizmi i autorizuar që në këtë rast nuk i referohen tabelës 8, por kryhet një ekzaminim në vend nga vetë organizmi i autorizuar për të stabilizuar moskonformitetin.

Organizmi i autorizuar i heq të drejtën e përdorimit të markës ndërmjetësit, në qoftë se vërehen kushte që nuk garantojnë mbajtjen e karakteristikave origjinale të produktit dhe/ose konstatohen veprime të qëllimshme. Ky veprim i komunikohet prodhuesit.

SHTOJCA A VLERËSIMI I PËRFAQËSUESHMËRISË DHE I PËRPIKMËRISË SË REZULTATEVE TË PROVAVE TË REZISTENCËS MEKANIKE NË SHTYPJE PAS 28 DITËSH

A.1 E përgjithshme

Kjo shtojcë përshkruan procedurat që duhet të përdoren për të vlerësuar përfaqësueshmërinë dhe përpikmërinë e rezultateve të provave të rezistencës 28-ditore. Vlerësimi është mirë të kryhet në rastin e inspektimit vjetor nga organi inspektues.

A.2 Grupi i rezultateve të marra në konsideratë

Procedura vlerësuese merr në konsideratë tri grupet e rezultateve të provave:

A — rezultatet e provave të autokontrollit gjatë periudhës së marrë në konsideratë.

B — rezultatet e provave të kryera nga prodhuesi në mostrat e marra për testimin kontrollues.

C — rezultatet e provave të kryera në laboratorin e provave në mostrat e marra për testimin kontrollues.

Numri i rezultateve për çdo grup B dhe C është minimumi 6. Ato duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjithë periudhën që merret në konsideratë.

A.3 Procedura vlerësuese

A.3.1. Hyrje

Procedura vlerësuese përfshin dy pjesë, siç përshkruhet në A.3.3. dhe A.3.4., për çimenton për muraturë shih gjithashtu A.3.5. Simbolet e përdorura janë listuar në A.3.2.

A.3.2 Simbolet

Simbolet e përdorura në A.3.3. — A.3.5. janë dhënë në tabelën A₁.

Tabela A₁ — Simbolet

Simboli	Kuptimi
M_A	Është mesatarja e të gjitha rezultateve të testimit të autokontrollit gjatë periudhës që merret në konsideratë.
M_B	Është mesatarja e rezultateve të provave të kryera nga prodhuesi në mostrat e marra për testim kontrollues.
M_C	Është mesatarja e rezultateve të provave të kryera nga laboratorit testues në mostrat e marra për testim kontrollues.
N_B	Është numri i mostrave të marra për testim kontrollues.
S_A	Është devijimi standard i të gjitha rezultateve të testimit të autokontrollit gjatë periudhës së marrë në konsideratë.
S_D	Është devijimi standard i diferencave ndërmjet rezultateve korresponduese të mostrave të marra për testim kontrolli siç përcaktohet nga $d_i = B_i - C_i$ Ku B_i është rezultati i provës individuale nga prodhuesi. C_i është rezultati i provës individuale korresponduese nga laboratorit testues. $S_D = [(\sum d_i^2 - (\sum d_i)^2 / (N_B - 1))]^{1/2}$

A.3.3 Vlerësimi nëse grupi A dhe B i takojnë të njëjit popullim (kontrolli i marrjes së gabuar të mostrës).

a) Kur $|M_A - M_B| \leq 2,0^2$ Mpa,

Dy grupet e rezultateve mund të konsiderohet që i takojnë të njëjit popullim.

b) Kur $|M_A - M_B| > 2,0^2$ Mpa,

Nëse $|M_A - M_B| \leq 2,58 \times S_A / (N_B)^{1/2}$

Dy grupet e rezultateve mund të konsiderohet që i takojnë të njëjit popullim.

Nëse $|M_A - M_B| \leq 2,58 \times S_A / (N_B)^{1/2}$

Arsyeja duhet të identifikohet nga prodhuesi. Në këtë rast, dy grupet e rezultateve të provave mund të konsiderohet që i takojnë popullimeve të ndryshme me një nivel besueshmërie 99%, siç përshkruhet në ISO 2854.

A.3.4. Krahësimi ndërmjet grupeve B dhe C me qëllim kontrollin e përpikmërisë së testimit të autokontrollit (kontrolli i gabimit të testimit).

Duhet të kënaqen dy kushte:

a) $S_D < 3,4^2$ MPa

b) $|M_A - M_B| < 4,0^2$ Mpa

Nëse njëra ose të dyja nga këto kondita nuk kënaqen, arsyet identifikohen nga prodhuesi dhe organizmi akreditues.

A.3.5. Çimentoja për muraturë

Për çimenton për muraturë (S SH EN 413— 1), në vend të vlerave të dhëna në A.3.3. dhe A.3.4, zbatohen kriteret e mëposhtme numerike:

Kriteret	Çimento muraturë, tipi/klasa		
	MC5	MC12.5/MC12.5X	MC22.5X
$ M_A - M_B $	1.0	1.4	2.0
S_D	1.7	2.4	3.4
$ M_B - M_C $	2.0	3.0	4.0

2) Këto vlera janë të zbatueshme për çimenton sipas S SH EN 197 — 1.

Vlerat për çimenton e muraturës janë dhënë në A.3.5. Vlerat për çimentot e tjera mund të tregohen në standardin specifik të produktit përkatës.

SHTOJCA B (INFORMATIVE)
EMËRTIME TË PËRGJITHSHME

B.1. Emërtime nga S SH EN 197—1, 2

B. 1.1 Tipi i çimentos së zakonshme

Një nga 27 produktet e familjes së çimentos (sipas tabelës te S SH EN 197-1).

B.1.2. Klasa e rezistencës së çimentos

Klasa e rezistencës në shtypje.

B.1.3. Prova e autokontrollit

Prova të vazhdueshme nga ana e prodhuesit të mostrave të veçanta të çimentos të marra në pikën (ose pikat) e daljes nga fabrika/depozita.

B. 1.4. Periudha e kontrollit

Periudhë prodhimi dhe shpërndarjeje e kryer për të vlerësuar rezultatet e provës së autokontrollit.

B. 1.5. Vlera karakteristike

Vlera e një cilësie të kërkuar, jashtë së cilës shtrihet një përqindje e caktuar P_k e të gjitha vlerave të shpërndarjes.

B. 1.6. Vlera karakteristike e specifikuar

Vlera karakteristike e një vetie mekanike, fizike ose kimike, e cila në rastin e një limiti të sipërm nuk duhet të kalojë ose në rastin e një limiti të poshtëm është minimumi që mund të arrihet.

B. 1.7. Vlera limite e një rezultati të vetëm

Vlera e një vetie mekanike, fizike ose kimike, e cila — për një rezultat të vetëm prove në rastin e një limiti të sipërm nuk duhet të kalojë ose në rastin e një limiti të poshtëm është minimumi që mund të arrihet.

B. 1.8 Propabiliteti i lejuar i pranimi CR

Për një plan të dhënë të marrjes së mostrës, propabiliteti i lejuar i pranimi të çimentos me një vlerë karakteristike jashtë vlerës karakteristike të specifikuar.

B. 1.9 Plani i marrjes së mostrës

Plan specifik i cili saktëson përmasën (përmasat) (stastistikore) të mostrës që do të merret, përqindjen P_k dhe propabilitetin e lejuar të pranimi CR.

B. 1.10. Mostër e veçantë

Mostër e marrë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend. Ajo mund të përftohet nga kombinimi i një apo më tepër marrjeve të njëpasnjëshme.

B. 1.11. Certifikata e konformitetit

Dokument i cili jepet për vlerësimin e konformitetit sipas rregullave të skemës, tregon se është siguruar besueshmëri e mjaftueshme që çimentoja të jetë në konformitet me standardin specifik të produktit përkatës.

8.1.12. Shenja e konformitetit

Shenjë e mbrojtur që përdoret në bazë të certifikatës së konformitetit.

B. 1.13. Çimento e certifikuar

Çimento për të cilën jepet një certifikatë konformiteti.

8.1.14. Periudhë fillestare

Periudhë ndërmjetëse pas lëshimit të parë të certifikatës së konformitetit për një çimento.

B. 1.15. Organizëm certifikues

Organizëm i paanshëm, qeveritar ose joqeveritar, që ka kompetencën dhe përgjegjësinë e nevojshme për të dhënë certifikatën e konformitetit sipas rregullave të procedurave dhe menaxhimit.

B.1.16. Kontrolli i produktit në fabrikë

Kontrolli i brendshëm i përhershëm i prodhimit të çimentos, i ushtruar nga prodhuesi, që përbëhet nga kontrolli i brendshëm i cilësisë i plotësuar nga provat e autokontrollit.

B.1.17. Fabrikë

Mjetet e përdorura nga prodhuesi për prodhimin e çimentos, duke përdorur pajisje të

përshtatshme për një prodhim në masë dhe të vazhdueshëm të saj, duke përfshirë në veçanti pajisjet, për një bluarje dhe homogjenizim të mjaftueshëm dhe kapacitetin e nevojshëm të sillozit, për magazinimin dhe shpërndarjen e çdo tipi çimentojeje të prodhuar. Këto pajisje dhe kontrolli i aplikuar i prodhimit sigurojnë kontrollin e produktit me saktësi të mjaftueshme në mënyrë që të sigurohet plotësimi i kërkesave të standardit specifik të produktit përkatës.

B. 1.18 Fabrikë e re

Fabrikë e cila akoma nuk prodhon çimento të certifikuara sipas kësaj skeme.

B.1.19 Depo

Mjet i trajtimit me shumicë të çimentos (i palokalizuar në fabrikë) e cila përdoret për shpërndarjen e çimentos (rifuxho ose e paketuar) pas transferimit ose depozitimit, ku prodhuesi ka përgjegjësinë e plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos.

B. 1.20 Qendër shpërndarjeje

Mjet i trajtimit me shumicë të çimentos (i palokalizuar në fabrikë) e cila përdoret për shpërndarjen e çimentos, pas transferimit ose depozitimit, ku ndërmjetësi ka përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos.

B. 1.21. Ndërmjetës

Person fizik ose juridik i cili merr me shumicë nga prodhuesi çimento, të certifikuar sipas S SH EN 197 — 2, me shenjë e konformitetit, që merr përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet e cilësisë së çimentos, për ruajtjen në një vend trajtimi me shumicë dhe furnizon me çimento persona të tjerë.

B.1.22. Konfirmimi i provave të autokontrollit

Testim i vazhdueshëm, kryer nga një ndërmjetësi, që konsiston në testimin e mostrave të marra prej tij në pikat e furnizuara prej qendrës së shpërndarjes.

B.1.23. Manuali i cilësisë së fabrikës

Dokument, i cili jep informacion mbi kontrollin e produktit në fabrikë nga prodhuesi, në mënyrë që të sigurohet konformiteti i çimentos me kërkesat e standardit specifik të produktit përkatës.